



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.10.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Besa Morina (udhëheqëse e ekipit) Fatlinda Podvorica dhe Aurora Morina (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 6 |
| 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 7 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 11 |
| 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 27 |
| 5 Qeverisja e mirë..... | 28 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA | 30 |
| Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme | 33 |
| Shtojca III: Letër konfirmimi | 37 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 30.10.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim çështje

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri i pasurisë nuk ishte i plotë si dhe obligimet financiare janë mbivlerësuar për vlerën e obligimeve kontraktuale.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrisë në auditimin 2017**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Pajisje të TI-së në vlerë 273,399€ donacion i BE dhuruar AZhB-së, janë pranuar dhe regjistruar në agjencion, por nuk janë përfshirë në regjistrin e pasurisë të MBPZhR-së shkak i mos raportimit të tyre në ministri. Po ashtu, në PFV pasuria nën 1,000€ është e nënvlerësuar për 384,792€. Sipas raporteve nga sistemi e-pasuria për MBPZhR dhe APK vlera neto e pasurive nën 1,000€, është 493,522€, përderisa në PFV ishin paraqitur vetëm blerjet e vitit 2017 në vlerë 108,730€;
- Sipas Komisionit për vlerësim të pasurisë, pronat tokësore të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) në vlerë 7,652,967€, nuk kontrollohen dhe shfrytëzohen nga IBK, dhe se të njëjtat shfrytëzohen nga individ privat. Ky vlerësim është bazuar në të dhënat e Agjencionit Kadastral të Kosovës ku titullar i pronave figuron IBK. Kjo e gjetur ishte edhe në raportin e vitit paraprak; dhe
- Shpалosja e obligimeve të pa paguara në PFV për vitin 2017 ishte në shumë 9,324,498€. Nga kjo vlerë 7,009,157€ nuk plotësojnë kriterin për të qenë obligim financiar pasi që janë obligime kontraktuale për grante, të cilat priten të përfundohen gjatë vitit 2018.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigorisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera (raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore, planin e prokurimit dhe raportin vjetor të nënshkrimit të kontratave).

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar çështje si në vijim:

- MBPZhR ka prezantuar në PFV detyrimet kontingjente në vlerë 522,700€. Gjatë krahasimit të dhënave të siguruara nga zyra ligjore vlera e detyrimeve kontingjente ishte 535,071€, kemi ka një diferencë prej 12,371€ nga vlera e prezantuar në PFV. Po ashtu, ne kemi përzgjedhur shtatë mostra në vlerë 116,000€ nga regjistri i Avokaturës Shtetërore dhe kemi vërejtur se të njëjtat nuk ishin prezantuar në PFV.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MBPZhR

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë përveç të gjeturave të theksimi i çështjes të cilat janë paraqitur tek nën kapitulli 2.1 Opinioni i Auditimit.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime që pasuria në pronësi të ministrisë të regjistrohet në regjistrin e pasurisë si dhe të gjitha pasuritë në posedim të ministrisë të shpalosen PFV. Gjithashtu duhet të siguroj që për pasurinë e shfrytëzuar nga personat privat ta rikthej nën kontroll përmes rrugëve ligjore.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të siguroj se shpalosja e obligimeve financiare të bëhet ndaras nga obligimet kontraktuale. Poashtu, duhet të bashkëpunojë me Avokaturën Shtetërore për harmonizim të regjistrave, në mënyrë që të paraqiten të gjitha detyrimet kontingjente.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MBPZhR në përgjithësi, ka vendosur kontrole të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i personelit dhe menaxhimi i subvencioneve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ¹ | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|---|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e Fondeve: | 57,596,233 | 55,180,610 | 50,811,220 | 50,857,566 | 57,520,945 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 54,392,718 | 52,103,331 | 49,742,305 | 47,719,241 | 52,643,388 |
| Të bartura nga viti paraprak ² - | | 93,764 | 93,764 | 81,018 | 81,328 |
| Të hyrat vetjake ³ | 183,515 | 183,515 | 56,042 | 89,751 | 146,428 |
| Financimi nga Huamarrja | 3,020,000 | 1,020,000 | 516,714 | 2,927,584 | 1,206,512 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 1,780,000 | 402,435 | 39,972 | 3,443,289 |

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,509,387€. Ky zvogëlim është rezultat i zvogëlimit të financimit nga huamarrja, shkurtimeve buxhetore dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, MBPZhR ka shpenzuar 92% të buxhetit final , me një nën shpenzim prej 7% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, lidhur me shfrytëzimin e buxhetit, më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 57,596,233 | 55,180,610 | 50,811,220 | 50,857,566 | 57,520,944 |
| Pagat dhe Mëditjet | 2,319,194 | 2,358,194 | 2,330,329 | 2,180,904 | 1,956,696 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,981,681 | 4,036,009 | 2,416,802 | 3,570,786 | 3,692,171 |
| Shërbimet komunale | 118,768 | 135,660 | 100,826 | 99,572 | 98,207 |
| Subvencionet dhe Transferet | 47,203,922 | 46,422,803 | 43,868,507 | 43,894,912 | 50,724,157 |
| Investimet Kapitale | 4,972,668 | 2,227,942 | 2,094,756 | 1,111,392 | 1,049,714 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte më i lartë për 39,000€ se buxheti fillestar. Ky buxhet është rritur me vendim të Qeverisë 11,358€ si dhe me rishikim të buxhetit për 27,642€. Realizimi ishte 99% e buxhetit final;
- Për mallra dhe shërbime, buxheti final ishte rritur për 1,054,328€ në krahasim me buxhetin fillestar. Rritja e buxhetit ishte rezultat i transferit të mjeteve nga Financimi dhe Huamarrja me aprovim të MF në shumë 311,119€, me vendim të Qeverisë në shumë 562,550€, me rishikim të buxhetit në shumë 75,000€, transfere të mjeteve nga kategoria subvencioneve për 37,450€ nga shërbimet komunale për 3,108€, dhe të hyrat e bartura 93,764€. Ndërsa shkurtimeve buxhetore ishin 28,663€, përkundër këtyre ndryshimeve realizimi i buxhetit final mbetet në nivel të ulët 60%;
- Buxheti për komunalitet ishte rritur për 16,892€ krahasuar me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi për 2017 ishte 74% e buxhetit final. Si rezultat i rishikimit të buxhetit kjo kategori ishte rritur për 20,000€, dhe zvogëluar për 3,108€, shkak i transferit të mjeteve nga shërbime komunale në mallra dhe shërbime;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 781,119€ krahasuar me atë fillestar, ndërsa realizimi për vitin 2017 ishte 94% e buxhetit final. Zvogëlimi i buxhetit ishte rezultat i shkurtimeve buxhetore me rishikim për 2,000,000€, transferit të mjeteve nga subvencione dhe transfere për 561,119€, në mallra dhe shërbime. Ndërsa është rritur për 1,780,000€ si rezultat i donacionit të pranuar nga Banka Botërore. Në këtë kategori në fund

të vitit kishte suficit prej 2,554,296€ përderisa kishte shumë obligime të pa paguara me arsyetimin – në procedurë për pagesë; dhe

- Buxheti final për investime kapitale ishte për 2,744,726€ më i ulët krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo ishte si rezultat i shkurtimeve buxhetore me rishikim për 1,324,734€ si dhe me vendim të qeverisë për 1,419,900€, për shkak të kursimeve në nën programe për projekte. Realizimi për investime kapitale në vitin 2017 ishte 94% e buxhetit final.

Çështja 3 – Realizimi i buxhetit

E gjetura

Gjatë vitit është paraqitur nevoja për shumë përshtatje në buxhet për shumicën e kategorive të shpenzimeve. Kjo ka ndodh ngase mjetet e buxhetit nuk janë shpenzuar sipas planit të rrjedhës së parasë.

Për vitin 2017, me buxhet fillestar ishte paraparë realizimi i 15 projekteve kapitale me vlerë totale 4,972,668€, mirëpo me rishikim të buxhetit ishin larguar dy projekte në vlerë 600,000€ si rezultat i mos realizimit të tyre. Katër projekte në vlerë 3,052,668€ kanë pësuar shkurtime buxhetore në vlerë 653,488€ pas rishikimit buxhetor. Realizimi i buxhetit për investime kapitale ishte 94%, ndërsa pjesa më e madhe e buxhetit apo 72% e tij ishte shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit.

Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur sipas kërkesave të Ministrisë, mirëpo shpenzimi ishte vetëm 2,416,802€ apo 60% e buxhetit final. Arsyeja e nivelit të ulët të shpenzimit ishte se ndryshimet buxhetore kishin ndodhur në fund të vitit.

Ministria kishte shpenzuar 1,360,542€, nga kodi 21200 (subvencione jo publike), mirëpo 1,088,058€ apo 80% e këtyre mjeteve ishin shpenzuar për kodet e pagesave direkte, pasi që ministria kishte mungesë të mjeteve në kodet përkatëse.

Rreziku

Nevojat e shumta për përshtatje janë tregues që buxheti nuk është hartuar duke u bazuar në kapacitetet reale të MBPZhR-së për realizimin e tij. Mos realizimi i projekteve kapitale të planifikuara dhe diferencat e theksuara mes planifikimit dhe shpenzimit, si te projektet kapitale ashtu edhe te shpenzimet në kode të caktuara, rrisin rrezikun që të mos arrihen objektivat e përcaktuara të Ministrisë.

Rekomandimi 3

Ministri duhet të siguroj që hartimi i buxhetit është mbështetur mbi një analizë të detajuar të të gjithë faktorëve që ndikojnë në realizimin e buxhetit pa diferenca të theksuara mes planifikimit dhe shpenzimit të mjeteve.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e planifikuar për vitin 2017 ishin 1,939,398, ndërsa ishin realizuar 2,265,297€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga taksat drusore, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat nga lëshimi i licencave. Pjesa më e madhe e të hyrave është realizuara nga APK, në vlerë prej 2,035,302€ ose rreth 90% të të hyrave të gjithëmbarshme. Ndërsa pjesa tjetër e të hyrave është realizuar nga shërbimet e ofruara nga departamentet tjera të MBPZhR.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2017 Pranimet | 2016 Pranimet | 2015 Pranimet |
|------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Të hyrat vetjake | 1,939,398 | 1,939,398 | 2,265,297 | 1,949,985 | 1,810,028 |
| Totali | 1,939,398 | 1,939,398 | 2,265,297 | 1,949,985 | 1,810,028 |

Të hyrat e vitit 2017 krahasuar me vitin e kaluar janë rritur për 315,312€ apo 16%. Në bazë të një marrëveshje me MF, të hyrat vetjake prej 183,515€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e OB-së, kurse pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK).

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MBPZhR, e të cilat ndërlidhen me autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Çështja 4 – Pagesa jo në pajtim me vendime dhe kontrata

E gjetura

Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

- Në 29 raste kemi vërejtur se të punësuarit si roje objekti, pastrues, punëtorë fushor, teknik fushor, roje pylli, marrin shtesën SHCK (30€) derisa marrëdhënia e tyre e punës rregullohet në bazë të Ligjit të Punës L-03/212. Gabimi financiar për vitin 2017 ishte 10,230€;
- Në APK ishin angazhuar katër zyrtarë me kontratë marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV), ku përveç pagës bazë marrin edhe shtesën prej 30€ të SHCK; dhe
- Në 10 raste kemi vërejtur se edhe pas aprovimit nga DASHC/MAP për ngritjen e koeficienteve nga 4.5 në 5 për pozitën: Roje pylli, gjueti dhe peshkim, tek të punësuarit në akt emerim koeficienti ende vazhdon të jetë 4.5 ndërsa në listë të pagave (payroll) kanë koeficientin 5.

-
- Rreziku** Pagesa e shtesave të cilat nuk janë të parapara me ligj dhe pagesat pa mbështetje me aktemrim rezultojnë me pagesa të parregullta të cilat mund të shkaktojnë humbje financiare për ministrinë.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj që janë shqyrtuar rastet e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e MBPZHR bëhet konform buxhetit të paraparë dhe në përputhje me vendimet e Qeverisë dhe kontratave të nënshkruara.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me, rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjet në vijim:

Çështja 5 - Mos-përfshirja e departamenteve në rregullore

- E gjetura** Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2017, MBPZHR kishte të aprovuara 392 pozita, me rregulloren e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës ministria kishte paraparë vetëm 329 pozita, ndërsa në fund të vitit ishin mbuluar 377 pozita. Dy nga departamentet që funksionojnë aktualisht në kuadër të ministrisë Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut nuk janë të parapara me këtë rregullore.
- Rreziku** Mos harmonizimi i rregullores së brendshme me Ligjin e Buxhetit mund të ndikojë, që të ketë mungesë të qartësisë në lidhje me detyrat dhe raportimin e departamenteve të cilat nuk janë përfshirë në rregullore.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të konsideroj mundësinë për inicimin e ndryshimit/përshtatjes së rregullores me rrethanat e reja në mënyrë që për departamentet e mbetura jashtë rregullores të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë.

Çështja 6 – Nënshkrimi i kontratave pa autorizim dhe ushtrimi i detyrës jo në pajtim me ligjin**E gjetura**

Gjatë testimeve identifikua se:

- Në bazë të nenit 1 të kontratës së punës për kohë të pacaktuar, thuhet se marrëdhënia e tyre e punës lidhet në mes të Sekretarit të Përgjithshëm (punëdhënësit) dhe zyrtarëve (punëmarrësve). Në 11 raste kemi vërejtur se kontratat janë nënshkruar nga Menaxheri i personelit pa ndonjë autorizim nga SP.
- Neni 30 paragrafi 4 i Ligjit për Shërbimin Civil nr.03/L-149 citon: Në rast të mbetjes së një pozitë të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Ne identifikua pesë raste të tilla për vitin 2017, që kishte tejkalim të këtij afati nga një deri në pesë muaj.

Rreziku

Nënshkrimi i kontratave nga zyrtari i paautorizuar sjellë deri te parregullsitë të cilat mund të reflektohen te llogaridhënia dhe përgjegjësia ndaj Zyrtarit Kryesor Administrativ. Po ashtu, mbajtja e pozitave me ushtrues të detyrave më gjatë se tre muaj rrezikon që institucioni të mos arrij të përmbush misionin dhe objektivat e organizatës.

Rekomandimi 6

Ministri duhet të siguroj që çdo marrëdhënie pune e lidhur brenda ministrisë të nënshkruhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ si dhe për pozitat me ushtrues detyre, përmes procesit të rekrutimit t'i plotësojë me punonjës të rregullt.

Çështja 7 - Procedurat e rekrutimit me MSHV**E gjetura**

MBPZHR për vitin 2017 kishte të angazhuar 38 punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, pa procedurë të rekrutimit. Në bazë të ligjit për shërbimin civil të Kosovës, këto i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për to duhet të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Të njëjtit ishin angazhuar në punë para nënshkrimit të marrëveshjes për punë, që është në kundërshtim me nenin 8 të kësaj marrëveshje, ku specifikohet se marrëveshja për punë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Rreziku

Angazhimi i punëtorëve me MSHV pa procedura adekuate të rekrutimit, rrit rrezikun që të angazhohen personat jo kompetent për pozitat përkatëse dhe kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional dhe mosarritje të objektivave të organizatës. Kryerja e punëve pa marrëveshje të nënshkruar e rrit rrezikun që punët të mos kryhen siç ishte paraparë.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të siguroj se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore. Dhe se, angazhimet e stafit në punë të bëhen vetëm sipas marrëveshjeve të nënshkruara.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 4,171,669€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,517,628€. Ato kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese, shpenzime mirëmbajtjeje, derivate dhe furnizime me material shpenzues.

Çështja 8 - Kontrata kornizë pa sasi indikative

- E gjetura** Sipas pikës 18.26 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik thuhet se Autoritetet kontraktuese do të specifikojnë sasi të gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat. Kontrata publike kornizë për “Zhvillimin e zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese” e nënshkruar me 12.07.2017 në vlerë 439,347€ me pagesë vjetore 146,449€, nuk kishte elemente të një kontrate publike kornizë. Në këtë kontratë mungonte sasia indikative (përafërt).
- Rreziku** Mos caktimi i sasive indikativë e pamundëson caktimin e limiteve të shpenzimit +/- 30% rrjedhimisht nuk dihet kufiri i obligimeve të AK ndaj OE. Mospërputhjet midis kontratës dhe projektit sjellin paqartësi lidhur me punën që duhet të kryhet si dhe afatet e kryerjes së punëve. Përveç kësaj, këto dallime rrezikojnë transparencën.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë që janë analizuar arsyet për dobësitë e identifikuara dhe t'i forcoj kontrollet gjatë procesit të prokurimit. Të gjitha procedurat duhet të zhvillohen në pajtim me Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 46,422,803€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 43,868,507€. Subvencionet ndërlidhen me zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural që kanë për qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e prodhimit të tyre. Pagesa e subvencioneve bëhet në formë të pagesave direkte (në Thesar) dhe në formë të granteve nga zyra e financave në MBPZhR. Politikat dhe buxheti përgatiten nga Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm (SP) ndërsa Implementimi i politikave bëhet nga AZhB-ja.

Çështja 9 - Vonesa në aprovim dhe mospërputhje në mes të programeve dhe udhëzimeve administrative

E gjetura Ministria nuk ka përcaktuar afat kohor për aprovimin e Programit të pagesave Direkte (PDR) dhe Programit për Zhvillimin Rural vjetor. Këto programe ishin aprovuar në shkurt të 2017. Ky fakt ka shkaktuar vonesë në procesin e subvencionimit duke filluar nga thirrja për aplikim, kontrollet në terren e deri te finalizimi i pagesës, sidomos për sipërfaqet e mbjellura me kultura të caktuara bujqësore.

Programi për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Programi për Pagesa Direkte ka mos përputhje me udhëzimet administrative për zbatimin e këtyre programeve. Kritere të vendosura në program mungojnë në udhëzime administrative si dhe anasjelltas kritere të vendosura udhëzime administrative që mungojnë në programe.

Sipas nenit 26, paragrafi 3 dhe 4 të UA 02/2017 për grante thuhet se procedimi administrativ përfundon në periudhën brenda tre muajve nga pranimi i aplikacionit deri tek letër informimi mbi vlerësimin e aplikacionit. Ndërsa sipas të njëjtit udhëzim, nuk përcaktohet ndonjë afat kohor prej letër informimit të vlerësimit të aplikacionit e deri te Miratimi i projektit.

Rreziku Realizimi i programeve më vonesë mund të rezultojë me bartjen e obligimeve kontraktuale/financiare në vitin në vijim. Po ashtu ndryshimet në mes të programeve dhe udhëzimeve administrative shkaktajnë paqartësi tek aplikantët që aplikojnë bazuar në kriteret e vendosura programin e aprovuar dhe se mund të eliminohen nga gara për përfitim për shkak se subvencionimi bëhet sipas udhëzimeve administrative. Mungesa e afateve pas procedimit administrativ të lëndës mund të ndikoj në vonesa në realizim të projekteve dhe rrezikon në mos arritjen e objektivave vjetore të ministrisë.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të siguroj që Autoriteti menaxhues harton programin me kohë me qëllim të implementimit të masave në kohën e duhur dhe programet e aprovuara nuk përmbajnë gabime të cilat duhet të ndryshohen pastaj me udhëzimeve administrative. Poashtu duhet të siguroj që janë vendosur afate për miratim të projekteve.

Çështja 10 - Vonesat në realizim të projekteve

E gjetura Afati për zbatimin e projekteve për investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore (masa 103) ishte tetë muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Ky afat mund të zgjatet për më së shumti dy muaj nëse ka arsye të forta për këtë, siç është sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi të huaj. Në 11 raste kemi vërejtur që përfituesit nuk kishin arritur të përfundonin projektet sipas kushteve të kontratës dhe kishin kërkuar shtyrjen e afatit edhe për dy muaj vetëm me një arsyetim me shkrim, pa ofruar dëshmi shtesë për shtyrje të afatit, edhe pse në kontratë/udhëzim administrativ cekët që arsyet duhet të jenë të forta për këtë aprovim.

Rreziku Aprovimi i shtyrjes së afatit për zbatim të projektit pa dëshmi të mjaftueshme, ka ndikuar që pagesat për këto projekte të bëhen në fund të vitit dhe volumi i madh i pagesave mund të rezultojë me gabime gjatë autorizimit të tyre.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të siguroj që aprovimet për shtyrje të afateve bëhen sipas udhëzimit administrativ dhe se arsyet për shtyrje mbështeten me dëshmi.

Çështja 11 - Aprovimi i pagesave pa zbatuar kriteret

E gjetura Sipas UA nr. 02/2016 një nder kriteret për përfitimin e pikëve ishte edhe numri i punëtorëve që do të punësohen në të ardhmen. Përfituesi kishte paraqitur në plan të biznesit rritjen e numrit të punëtorëve prej shtatë deri nëntë persona dhe për këtë kishte përfituar nëntë pikë, për secilin punëtor nga një pikë. Zbatimi i këtij kriteri duhet të dëshmohet në AZhB me rastin e paraqitjes së kërkesës për pagesë, përfituesi kishte dëshmuar vetëm për shtatë punëtor, çka do të thotë së është mbivlerësuar me dy pikë.

Ndërsa në rastin tjetër ishte prezantuar angazhimi i pesë punëtorëve me mundësi rritje deri në 15 punëtorë, sipas këtij deklarimi përfituesi kishte fituar pikët maksimale saktësisht 10 pikë, ndërsa kishte dëshmuar vetëm për gjashtë persona.

Sipas neni 29 pika 10 të UA 02/2016 -“Prej ditës së dorëzimit të kërkesës për pagesë deri te ekzekutimi i pagesës nuk duhet të kalojnë më shumë se 40 ditë. Në shtatë raste kishte tejkalim të këtij afati mbi dy muaj për projektet që kishin të bëjnë me vitin 2016.

Rreziku Autorizimi i pagesave pa plotësimin e kriterit i cili kishte ndikuar në përfitim të projektit rrezikon që të mos arrihet objektivat e ministrisë për rritje të punësimit në sektorin bujqësor. Vonesat në procedimin e kërkesave për pagesë nga ana e Autoritetit të Pagesave rrezikon që të krijohen obligime financiare të cilat e ngarkojnë buxhetin e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të siguroj se autorizimi i pagesave bëhet vetëm në rastet kur dëshmohet se janë zbatuar kriteret të cilat kanë ndikuar në përfitimin e projektit si dhe procedimi i kërkesës për pagesë të bëhet konform afateve të përcaktuara me udhëzim administrativ.

Çështja 12 – Rikontroll pas përfundimit të afateve për zbatim të projektit

- E gjetura** Përfituesi i grantit për projektin ‘Ndërtimi i qumështores së re’, nuk kishte arritur t’i përfundoj punimet brenda afatit dhe kishte kërkuar shtyrje të afatit për zbatim të projektit siç parashihet në kontratë. Pas përfundimit të afateve të përcaktuara në kontratë kishte bërë kërkesën për pagesë, mirëpo Departamenti i kontrollit kishte identifikuar disa pozicione të papërfunduara. Pas kësaj, përfituesi më vonë kishte bërë kërkesë për rikontroll me arsyetimin se tani janë kryer të gjitha punimet. Edhe pse sipas udhëzimit administrativ nuk parashihen rikontrollet, Departamenti për autorizim të pagesave kishte kërkuar që të kryhet ky rikontroll, i cili kishte konstatuar se ishin përfunduar punimet.
- Rreziku** Kryerja e rikontrolleve në kundërshtim me udhëzimin administrativ ndikon në zvogëlimin e besueshmërisë së procesit dhe mund të rezultojë me pakënaqësi tek fermerët tjerë për mos trajtim të barabartë.
- Rekomandimi 12** Ministri duhet të siguroj se kushtet vendosura në kontratë dhe udhëzim administrativ zbatohen nga zyrtarët përgjegjës të AZhB-së.

Çështja 13 – Monitorimi i projekteve Ex-post kontrolli

- E gjetura** Departamenti i kontrollit gjatë vitit 2017 kishte përzgjedhur 338 përfitues të granteve për vitin 2015 për të kryer Ex-post kontrolle. Prej tyre, 106 lëndë nuk ishin të kompletuara⁴, dhe janë kthyer në arkivë si të pa kontrolluara. Nga ky departament ishin kontrolluar vetëm 232 lëndët e kompletuara, prej tyre në 107 ishin evidentuar probleme të cilat janë dërguar në Departamentin e pagesave për procedim të mëtutjeshëm. Në shumicën e rasteve mungonin dëshmitë për pagesën e tatimit dhe kontributit për punëtorë, mungonin pajisje të financuara nga AZHB si dhe projekte të cilat nuk janë funksionale.
- Rreziku** Mungesa e dokumentacionit në lëndët e përzgjedhura për Ex-post kontrolle rrezikon që përfituesit e pa kontrolluar nuk i kanë përmbushur kriteret e vendosura sipas kontratës si dhe zvogëlon mundësinë që të fillohet me procedura për kthim të mjeteve për mos zbatim të kontratës.
- Rekomandimi 13** Ministri duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet e mos kompletimit të lëndëve dhe se lëndët e pa kontrolluara duhet t’i nënshtrohen procesit të kontrollit. Gjithashtu, duhet të siguroj se dosjet e përfituesve do të indeksohen sipas renditjes dhe dorëzohen në arkivë dhe se të njëjtat me rastin e kërkesave dorëzohen të kompletuara. Poashtu duhet të shikojë mundësinë e krijimit të dosjeve elektronike.

⁴Mungonte pakoja e aplikimit për pagesë dhe raportet e kontrollit

Çështja 14 – Komisionet për shqyrtim të ankesave

E gjetura

Gjatë vitit 2017 MBPZhR kishte formuar komisionin për shqyrtim dhe vlerësim të ankesave për Grante. Ky komision përgjatë punës së tij kishte mos pajtime me zyrtaret e AZhB-së, pasi që në 46 rastet për të cilat komisioni për shqyrtim të ankesave kishte vendosur ndryshe nga Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural, dhe rekomandimet e komisionit nuk ishin zbatuar. Ne kemi testuar dy raste dhe kemi vërejtur se:

- Në rastin e parë ishte kërkuar që pronë të jetë në emër të aplikuesit, ndërsa aplikuesi kishte paraqitur pronën e privatizuar nga AKP-ja, ku në fletën poseduese shkruan 99 vite me qira. Kriteri i vendosur nga ministria ka qenë diskriminues dhe për këtë çështje Komisioni kishte kërkuar interpretim ligjor nga AKP dhe zyra ligjore e MBPZhR-së. Përgjigja e tyre ishte bazuar në Rregulloren e UMNK – ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës Patundshme në Pronësi Shoqërore. Në bazë të kësaj rregullore, të nenit 2.1 pika: (a) Të drejtën e zotërimit dhe përdorimit të pronës së dhënë me qira për çfarëdo qëllimi që nuk ndalohet sipas ligjit në fuqi; (b) Të drejtën e transferimit lirish të pronës nën qira tek palët e treta.; (c) Të drejtën e vendosjes së barrëve mbi pronën nën qira e kushtëzuar në dobi të palëve të treta. Bazuar në këtë interpretim komisioni e kishte kthyer lëndën në rishqyrtim, mirëpo AZhB e kishte refuzuar edhe pas rivlerësimit.
- Edhe rasti dytë nuk ishte marrë parasysh nga AZhB pasi që dokumenti për të cilin ishte refuzuar aplikacioni, ishte prezantuar së bashku me ankesë te komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe nuk figuronte në dosje me rastin e aplikimit.

E gjetura

Ndërsa Drejtoria e pagesave direkte kishte kundërshtuar në 35 raste komisionin për shqyrtim të ankesave për pagesa direkte. Ne kemi testuar dy raste dhe kemi vërejtur se:

- Në rastin e parë komisioni kishte rekomanduar që fermeri të kompensohet pasi që ka pasur kontratë valide për qira marrje me AKP deri në fazën e korrjes së grurit. Ky konstatim i komisionit nuk ishte i saktë pasi që kontrata kishte përfunduar me 30.04.2017.

- Ndërsa në rastin tjetër, në vendimin e komisionit thuhet që të mos sanksionohet me masën e futjes në listën e zezë, pasi që është vërtetuar se kulturat bujqësore i janë dëmtuar nga kushtet klimatike. Sipas udhëzimit administrativ fermeri është i obliguar që të informojë me kohë për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë. Fermeri nuk kishte informuar për dëmet e shkaktuara nga kushtet klimatike dhe nuk kishte dëshmi për këtë ankesë.

Rreziku Paqartësitë e krijuara në mes komisioneve dhe zyrtarëve të AZhB-së në interpretimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative mund të ndikojë që të dëmtohen fermerët ose të dëmtohet buxheti i Kosovës.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të siguroj që janë vendosur kritere të qarta në program dhe udhëzime administrative që mos të ketë paqartësi në interpretimin e tyre. Po ashtu të sigurojë se komisioni për shqyrtim të ankesave vepron në pajtim me udhëzimet administrative.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,227,942€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 2,094,756€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes në Kosovë, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja e tyre, softuer-sistemin e integruar informativ bujqësor dhe furnizime me pajisje të TI dhe pajisje laboratorike.

Çështja 15 – Mos respektimi i kriterëve gjatë vlerësimit të tenderëve

E gjetura Tek kontrata për “Renovimin-mirëmbajtjen e rrugëve pyjore në Blinajë” në vlerë 49,390€, nuk ishte plotësuar kriteri i përcaktuar në dosjen e tenderit. Sipas dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional ishte kërkuar që udhëheqësi i punishtes të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, infrastrukturë rrugore, derisa OE fitues kishte prezantuar si udhëheqës të punishtes një inxhinier të diplomuar të arkitekturës.

Rreziku Përzgjedhja e OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret, ndikon në zvogëlimin e besueshmërisë së procesit dhe mund të rezultojë me shërbime jo cilësore.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se kontratat lidhen me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 16 – Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kode ekonomike

E gjetura Në 10 raste, në vlerë të përbashkët 443,422€, shpenzimi është regjistruar në kodin ekonomik 32100 (Toka). Tre raste kanë të bëjnë me projektet për zgjerimin e sistemit të ujitjes në fshatra, ndërsa rastet tjera kanë të bëjnë me pyllëzimet vjeshtore në sipërfaqe të zhveshura, rrallimet dhe mirëmbajtja e pyllëzimeve;

Në katër raste, pagesa e avancit nuk është regjistruar në kodin 31910 - Avans për investime, tre nga këto raste në vlerë të përbashkët 216,492€, janë regjistruar në kodin ekonomik 32100 (Toka), ndërsa pagesa prej 56,640€ është regjistruar në kodin ekonomik 31680 (softuer);

Po ashtu njëjtë ishte edhe te mallrat dhe shërbimet, ku dy pagesa nuk ishin regjistruar në kodin 13830- Avans për mallra dhe shërbime. Pagesa në vlerë 65,902€ është regjistruar në kodin ekonomik 13440 (Shërbime të ndryshme intel.& këshillëdhënëse) si dhe tjetra në vlerë 52,842€ e regjistruar në kodin ekonomik 13460 (Shërbime kontraktuese).

Rreziku Pagesat e avanceve nga kodet e shpenzimeve si dhe regjistrimi i shpenzimeve në kode joadekuat rrisin rrezikun për mosparaqitje të drejtë të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të sigurojë që zyrtari i shpenzimeve e bën klasifikimin e duhur të shpenzimeve sipas planit kontabël dhe shpenzimet regjistrohen nëpër kodet përkatëse.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale mbi 1000€ e paraqitur në PFV është 39,169,040€, vlera e pasurisë jo kapitale nën 1000€ është 108,730€ si dhe vlera e stoqeve 31,808€. Përveç çështjes të kapitullit 2.1 (Theksimi i çështjes), identifikua edhe çështjet si në vijim:

Çështja 17 - Procedurat e brendshme për menaxhimin e pasurisë

E gjetura Ministria ende nuk ka nxjerrë procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë siç parashihet me Rregulloren MF-02/2013.

Sipas nenit 19 paragrafi 4.3 të rregullores MF-Nr.02/2013-për menaxhimin e pasurisë, është përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo financiare të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Komisioni i inventarizimit kishte përfunduar inventarizimin, por nuk e kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Kryeshefi i AZhB-së kishte formuar komision të veçantë për inventarizim nga ai që ishte themeluar sipas vendimit të SP, si dhe të dhënat e dala nga ky raport nuk ishin harmonizuar me të dhënat e MBPZhR.

Më tutje, sipas nenit 6 paragrafi 4.5 të Regjistri kontabël i pasurive jo financiare përveç informatave të kërkuara nga LMFPF do të përfshihen ndër tjera edhe numri i barkodit. Gjatë testimit/ekzaminimit fizik, kemi hasur në pajisje pa numër barkodi në AZhB, IBK dhe APK.

Rreziku Mos krahasimi i regjistrit të pasurisë me gjendjen reale dhe mungesa e barkodit, vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të shtyjë procesin për hartimin e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe të siguroj një menaxhim efektiv në pajtim me rregullat. Poashtu, duhet të sigurojë që komisioni i themeluar nga SP për inventarizim të shtrijë veprimin në gjithë ministrinë dhe të ofrojë një raport të plotë në pajtim me rregulloren mbi menaxhimin e pasurisë.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e Arkëtueshme kryesisht kanë të bëjnë me qiratë, dhe totali i tyre i paraqitur në PFV të 2017 është 1,703,941€, pjesa më e madhe i përkasin APK dhe kanë të bëjnë me obligime për rikultivimin e tokave të cilat ishin dhënë në shfrytëzim.

Çështja 18 - Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore

- E gjetura** Sipas nenit 30 pika 30.1 të Ligjit Nr 02/L-26 - Toka bujqësore mund t'u ipet me qira personave fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj të cilët merren me veprimtari bujqësore. Ne kemi vërejtur se në 16 raste, qiramarrësit e tokave bujqësore nuk ushtronin veprimtari përkatëse. Përveç kësaj, 12 prej tyre, nuk kishin paguar vlerën e obligimeve totale ishte 1,286,290€. Sipas kushteve të kontratës pagesa e obligimit duhet të bëhet deri me datën 10 të çdo muaji vijues.
- Rreziku** Dhënia në shfrytëzim e tokës bujqësore në kundërshtim me kërkesat ligjore rrezikon ruajtjen dhe mbrojtjen e potencialit bujqësor, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Borxhet e pa arkëtuara paraqesin një performacë jo të mirë të ministrisë respektivisht APK-së dhe rrisin rrezikun që të ketë humbje financiare për shkak të mos shlyerjes së detyrimeve ndaj MBPZhR-së.
- Rekomandimi 18** Ministri duhet të sigurojë që dhënia në shfrytëzimin e tokave bujqësore bëhet vetëm në përputhje me kriteret e parapara me ligj, si dhe duhet siguruar që të ndërmerren hapa lidhur me arkëtimin e borxheve të vjetra.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 9,324,498€ e prezantuar në PFV. Për më gjerësisht, referojuni kapitullit 2.1(Theksimi i çështjes).

Çështja 19 - Raportim jo i plotë dhe vonesa në realizimin e pagesave

- E gjetura** Sipas neni 37, paragrafi 1 të rreg. 01/2013 MF- Shpenzimi i parave publike, - Të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve. Ne identifikuam se në katër raste kishte tejkalim të këtij afati nga 20 ditë deri në pesë muaj. Po ashtu, nga faturat e paguara në vitin 2018 (periudha janar-mars) për obligimet e vitit 2017 identifikuam se nëntë fatura në vlerë totale 10,829€ nuk ishin të prezantuara në PFV si obligime të vitit 2017.
- Rreziku** Raporti jo i plotë i obligimeve të pa paguara, dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë me humbje të faturave dhe rrjedhimisht MBZhR nuk do të ketë informacionin e duhur dhe në kohë lidhur me obligimet paraprake, po ashtu ministria mund të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.
- Rekomandimi 19** Ministri duhet të siguroj se ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të MBPZhR ka rezultuar në 12 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, nga 12 rekomandimet e dhëna në vitin 2016, katër rekomandime janë zbatuar, pesë janë në proces dhe tre nuk janë adresuar ende. Po ashtu nga viti 2015 ishin bartur edhe tetë rekomandime, prej tyre tre janë adresuar, dy janë në proces të zbatimit dhe tre mbesin të pa adresuara. Përderisa nuk janë zbatuar rekomandimet e vitit 2016 dhe ato të viteve të mëhershme, të njëjtat mangësi përsëriten edhe në vitin 2017. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 20 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si subvencione dhe transfere, pasuritë, menaxhim i personelit, mallra dhe shërbime, të hyrat dhe tjera kanë rezultuar në:

- Mos- efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe përsëritje të të njëjtave mangësi;
- Dobësi në monitorimin e projekteve të subvencionuara; dhe
- Mos hartimi i procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MBPZHR veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura, po ashtu Komiteti i auditimit nuk është funksional.

MBPZHR ka dy agjencione, Agjencioni Pyjor i Kosovës (APK) dhe Agjencioni për Zhvillim të Bujqësisë (AZhB). Agjencioni Pyjor i Kosovës përgatit pasqyra financiare të cilat janë të konsoliduara në PFV-të e MBPZHR për derisa edhe më tutje mbetet sfidë konsolidimi i AZhB me staf të strukturuar që të funksionoj si agjencion ekzekutiv. Për më tepër 50% e stafit të AZhB-së janë të punësuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe përmes marrëveshjes me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe projektit të Bankës Botërore.

Kontrollet ishin të dobëta në menaxhim të pasurisë, personelit, menaxhimit të subvencioneve dhe realizimin e projekteve kapitale.

MBPZHR ka të hartuar planin zhvillimor strategjik 2014-2020 dhe bazuar në këtë strategji, ministria për çdo vit harton Programin për Zhvillim Rural (PZHR) dhe Programin për pagesa direkte si dhe harton Udhëzimet Administrative për zbatim të këtyre programeve.

Sa i përket raportit të vetëvlerësimit, MBPZHR ka dorëzuar në afat kohor në Ministri të Financave.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe tre auditorë. NjAB ka të aprovuar planin vjetor të auditimit, ky plan ishte bazuar në planin strategjik. Për vitin 2017 kishte planifikuar të kryente dhjetë auditime që shumica prej tyre ishin fusha me rrezik të lartë. Deri në fund të vitit kishte kryer të gjitha auditimet e planifikuara.

Çështja 21 –Dobësi në funksionimin e NjAB

| | |
|-----------------------|--|
| E gjetura | Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si: <ul style="list-style-type: none"> • Komiteti i Auditimit nuk ishte funksional gjatë vitit 2017, siç kërkohet me udhëzim administrativ 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të auditimit; dhe • Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë zbatuar rreth 54% nga ana e menaxhmentit, ose vetëm 42 rekomandime janë zbatuar nga 77 sa janë dhënë, 30 janë në proces dhe pesë janë të pa zbatuara. Pothuajse situata është e njëjtë sikur në vitin e 2016 sa i përket zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB. |
| Rreziku | Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar. |
| Rekomandimi 21 | Ministri duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit i Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm. |

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti mban takime të rregullta, në baza javore, me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e saj. Po ashtu, MBPZHR është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjencive të saj vartëse. Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Ministri, përderisa Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për konsolidimin e pasqyrave financiare. Për qëllime të konsolidimit të informatave dhe raporteve financiare, agjencitë dërgojnë raporte në departamentin e financave të MBPZHR-së. Agjencioni i Pyjeve të Kosovës harton pasqyra financiare të cilat konsolidohen me ato të ministrisë ndërsa AZhB ende nuk e ka kompletuar strukturën për të funksionuar si një agjencion ekzekutiv.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimet e bartura nga viti 2015 | Të zbatuara gjatë vitit 2017 | Në proces të zbatimit gjatë 2017 | Të pa zbatuara |
|-------------------------------------|--|------------------------------|---|-------------------------------|
| 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak | Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. | | MBPZhR ka treguar përkushtim në zbatimin e rekomandimeve, mirëpo mbetet sfidë zbatimi i plotë i tyre. | |
| 3 Menaxhimi Financiar dhe kontrolli | Ministri duhet të siguroj klasifikimin e transaksioneve sipas kodeve të reja ekonomike të përcaktuara nga Thesari si dhe të forcoj kontrollet financiare për evituar gabimet lidhur me regjistrimet e shpenzimeve dhe raportimin e tyre. | | | Rekomandimi nuk është zbatuar |
| 3.5.1 Pagat dhe meditje | Ministri duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit, të vazhdoj përpjekjet me MF dhe të paraqes arsyet me rastin e aprovimeve buxhetore për nevojat e stafit sipas departamenteve dhe të siguroj se kërkesat buxhetore lidhur me numrin e të punësuarve janë në përputhje me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës. | | | Rekomandimi nuk është zbatuar |
| 3.5.2 Subvencionet dhe transferet | Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurojnë rritjen e aktiviteteve monitoruese të granteve, monitorimet që pasqyrojnë rrezikun e vlerësuar dhe ato të kryhen rregullisht dhe me kohë. Në anën tjetër të konsideroj edhe kapacitetet e mjaftueshme të burimeve njerëzore për arritjen e rezultateve të duhura. | | | Rekomandimi nuk është zbatuar |

| | | | | |
|---|---|-------------|--|--------------------------------|
| 3.6. Te hyrat | Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të regjistrimit, që mbështet mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Një vlerësim duhet të bëhet bazuar në kompleksitetin e njohur të operacioneve ekzistuese, për ta përcaktuar nëse kjo duhet të bëhet me anë të softuerit. | | | Rekomandimi nuk është zbatuar. |
| Komponenta e auditimit | Rekomandimet e dhëna në vitin 2016 | Të zbatuara | Në proces të zbatimit | Të pa zbatuara |
| 1 Pasqyrat Financiare Vjetore | Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime efektive për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të siguruar një klasifikim të duhur të shpenzimeve dhe vlerësim të saktë të pasurive dhe raportim të drejtë të tyre në PVF 2017. Edhe kërkesat tjera për raportim duhet të përmbushen plotësisht. | | Janë ndërmarrë masa për përmirësime në klasifikim të shpenzimeve, mirëpo nuk janë bërë përmirësime e duhura në regjistrimin dhe raportimin e pasurive. | |
| 2.1 Qeverisja | Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plotësisht plani i veprimt, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. | | MBPZhR ka treguar përkushtim në zbatimin e rekomandimeve, mirëpo mbetet sfidë zbatimi i plotë i tyre. | |
| 2.2 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit | Ministri duhet të sigurojë se procesi i plotësimit të pyetësorit të vet-vlerësimit rishikohet në mënyrë kritike dhe bëhet adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Po ashtu duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. | Po | | |

| | | | | |
|--|---|----|---|-------------------------------|
| 2.3 Rishikimet specifike te qeverisjes | Ministri duhet ta rishikojë strukturën ekzistuese të AZhB-së dhe të përcaktoj se cilat janë pengesat në konsolidimin e saj dhe kryerjen e spektrit të plotë të detyrave. Ministri në bashkëpunim me Ministrin e Financave duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar që plotësimi i stafit dhe decentralizimi i funksionit të ekzekutimit të pagesave do të implementohet gjatë vitit 2017. | | Pjesërisht, pasi që është në proces të plotësimit të stafit të AZhB-së, mirëpo ende nuk është arritur decentralizimi i funksionit të ekzekutimit të pagesave. | |
| 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm | Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë një Komitet të Auditimit efektiv i cili rishikon në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit. | | | Rekomandimi nuk është zbatuar |
| 3.2 Te hyrat | Ministri duhet t'i analizojë shkaqet për papajtueshmëritë e identifikuara dhe ta konfirmojë dizajnin e kontrolleve të brendshme për të siguruar që do të adresohen sfidat që po e përcjellin APK-në në respektimin e kërkesave legislative. Kufizimi i qasjes në të gjitha informatat/ dokumentet relevante nga zyrtarët financiar duhet të trajtohet me prioritet të lartë për të siguruar një rrjedhë të kërkuar të informatave si parakusht për zbatimin e një qeverisjeje efektive. | Po | | |
| 3.3 Pagat dhe mëditjet | Ministri duhet t'i rishikojë shkaqet për dobësitë në menaxhimin e personelit. Duhet të ndërmerren veprime efektive për ta adresuar organizimin e brendshëm dhe procesin e rekrutimit për pozitat e lira dhe ato me ushtrues detyre duke siguruar harmonizim me rregulloren për sistematizimin e vendeve te punës. | | | Nuk është adresuar. |

| | | | | |
|---|--|----|--|-------------------|
| 3.4 Mallra dhe shërbime si dhe shërbimet komunale | Ministri duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me menaxhimin e kontratave dhe, sipas nevojës, t'i forcojë ato për të siguruar që projektet kryhen në pajtim me qëllimin dhe me mbikëqyrje efektive nga ana e MBPZhR-së. Pagesat për shërbime këshillimore duhet të bëhet vetëm nëse janë përmbushur kushtet e kontratës dhe dokumentimi duhet të jetë i plotë dhe cilësor. | Po | | |
| 3.5 Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të analizojë pse nuk përdoret IACS dhe të sigurojë që përdorimi i këtij sistemi do të fillojë brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kontrollet lidhur me përgatitjen e PDR-së dhe procedimin e aplikacioneve duhet të rishqyrtohen për të siguruar që të gjitha proceset përfundojnë brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe rregulloret relevante. Të gjitha programet duhet të zbatohen në kohë adekuate për të siguruar arritje efektive të objektivave për zhvillimin e bujqësisë. | | Në proces të zbatimit pasi që sistemi i integruar të administrimit dhe kontrollit IACS është shumë i kushtueshëm dhe se nuk mund të bëhet realizimi i tij brenda një viti. | |
| | Ministri në bashkëpunim me Kryeshefin e AZhB-së duhet të sigurojë se ekzistojnë përgjegjësitë e qarta lidhur me monitorimin e projekteve dhe të adresojë sfidat e identifikuara në këtë proces. Duhet të vendosen mekanizma efektive për të siguruar një garanci që grantet e përfituara përdoren nga fermerët në pajtim me kontratën dhe qëllimin e projektit. | | Pjesërisht pasi që raporti i monitorimit mbetet draft dhe se lendet për Ex post kontrole janë të pakompletuara. | |
| | Ministri duhet të kryejë një rishikim të kontrolleve lidhur me menaxhimin e subvencioneve tjera dhe të sigurojë që të gjitha procedurat e përzgjedhjes dhe pagesave janë në pajtim të plotë me kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. | Po | | |
| | Ministri duhet të iniciojë shkrimin e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë për të siguruar një menaxhim efektiv të tyre në pajtim të plotë me rregullat. Procedurat e brendshme duhet të përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e stafit lidhur me menaxhimin e pasurive në mënyrë sistematike. | | | Nuk është zbatuar |

Shtojca III: Letër konfirmimi

| | | | |
|--|------------|-----------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO | | | |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE | | | |
| DATE: 22.06.2018 | | | |
| Klasifikim | Klasifikim | Nr. Prot. | Nr. Faqeve |
| 03 | 47 | 1134 | 1 |



| | |
|-------------------------------------|--|
| KODI I DOKUMENTIT / DOCUMENT CODE | |
| 2623 | |
| Nr. i Follës / No. Pages | |
| 1 | |
| Data e Miratimit / Date of Approval | |
| 22.06.2018 | |

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
 Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); si dhe pas takimit përmbyllës
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Nenad Rikalo *Nenad Rikalo*
 Ministër - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Data: 22 Qershor, 2018, Prishtinë,